



NËNSHKRUHET MEMORANDUMI PËR BASHKËPUNIM NDËRMJET DREJTORISË SË TË ARDHURAVE PUBLIKE DHE KOMISIONI I LETRAVE ME VLERË

Drejtoresha e Drejtorisë së të Ardhurave Publike, Sanja Llukarevska dhe Kryetarja e Komisionit të Letrave me Vlerë, Nora Aliti, sot nënshkruan Memorandum për bashkëpunim. Me këtë dokument, siç edhe sqaruan nënshkruet, do të përparojë bashkëpunimi ndërinstytucional, ndërsa do të mundësohet edhe përforcimi i sistemit financiar dhe tatimor, të cilët janë shtyllat udhëheqëse të ekonomisë.



Drejtoresha e DAP Llukarevska, sqaroi se nëpërmjet bashkëpunimeve të tilla, përforcohen kapacitetet e dy institucioneve dhe krijohet bazë solide që DAP dhe KLV në partneritet të përballohen me evazionin fiskal dhe manipulimet në treg.

Kryetarja e KLV Aliti, sqaroi se me nënshkrimin e Memorandumit funksionalizohen më shumë segmente të bashkëveprimit përmes investimit të përbashkët, ndërsa krijohen kushte për ndërtimin e politikave përkatëse për sjelljen e vendimeve të qëndrueshme, me qëllim të modernizimit të sektorit financiar dhe tatimor.





Llukarevska dhe Aliti, theksuan se zbatimi praktik i këtij bashkëpunimi fillon menjëher, me qëllim që sa më shpejtë të krijohen kushte për përmirësimin e klimës së biznesit, shërbime moderne dhe transparente të cilat do të kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin e mundësive për investime dhe përmirësimin e klimës së biznesit nga të cilat përfitime do të kenë subjektet si dhe obliguesit tatimorë dhe investitorët.